

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës- koleji i përbërë nga gjyqtaret: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsha Boriçiq, anëtar me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dentarëve S. B. nga Peja, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK, ndërsa F. S. nga Obiliqi, për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit F. S., A. A., avokat nga Prishtina, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Departamenti për Krime të Rënda, PKR .nr. 72/2014 datë 19.06.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR. Nr. 517/2015 datë 10.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17 maj 2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit F. S., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda, Prishtinë PKR .nr. 72/2014 datë 19.06.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PAKR. Nr. 517/2015 datë 10.12.2015.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda Prishtinë, PKR. nr. 72/2014 datë 19.06.2015, të dënuarit S. B. është shpallur për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par. 3 lidhur me par. 1 dhe 31 të KPK, ndërsa F. S., për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par. 3 lidhur me par. 1 dhe 31 të KPK dhe për këto vepra janë gjykuar, S. B. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh, në të cilin dënimi është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 29.11.2011 e tutje dhe me dënim me gjobë në shumë prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) €, ndërsa F. S., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 29.11.2011 gjerë më 14.12.2012. dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) €. Dënimet me gjobë janë të detyruar që të paguajnë në afat prej 15 ditësh e në rast të mospagesës të njëjtat do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur çdo 15 € me një ditë burgimi. Ndaj të dënuarës S. B., është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit heroin me peshë prej 22.992, 40 gram. Janë detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën se cili veç e veç sipas fletës përfundimtare të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr. 517/2015 datë 10.12.2015, si në vijim:

“I.Perkitazi me ankesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës, të mbrojtësit të akuzuarës S. B. dhe të mbrojtësit të akuzuarit F. S., e sipas detyrës zyrtare,

ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR. nr. 72/2014, datë 10.06.2015, përkitazi me cilësimin juridik të veprave penale, e më afër të përshkruar si në dispozitiv I dhe II, për të akuzuarën S. B. dhe për të akuzuarin F. S., ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarën S. B. dhe të akuzuarin F. S., i shpall fajtor se kanë kryer vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja shitja e paautorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm dhe substancave psikotripike, nga neni 229 par. 4 nën. par 1. Të KPK, dhe dënim i shqiptuar me gjobë dhe me burgim për të akuzuarën S. B. në shumë prej 4.500 (katërmijepesëqind) €, dhe me dënim burgim në kohëzgjatje prej 7 ( shtatë ) vite, e në të cilin dënim me burgim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.11.2011 e tutje, merren si të vërtetuar, edhe për të akuzuarin F. S. dënim i shqiptuar me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) € dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, e në të cilin dënim me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.11.2011, deri me datë 14.12.2012 merren si të vërtetuar, e akuzuara dhe i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë, janë të obliguar që ta paguajnë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse e akuzuar dhe i akuzuar dënimet e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e caktuar, të njëjtat kanë për të ekzekutuar me detyrim, ashtu që për çdo 20 €, i caktohet një ditë burgim, në pjesët e tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

II. Ankesat e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe të mbrojtësit të akuzuarës S. B. dhe të mbrojtësit të akuzuarit F. S., refuzohen si të pabazuara.”

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F. S., A. A. avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuar të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkalles së parë për rigjykim. Njëherësh ka propozuar që të shtyhet ekzekutimi i aktgjykimit të formës së prerë.

Prokurori i Shteti të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr 51/2016 datë 21.03.2016 ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoj të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK, dhe pasi vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale nga dispozita e nenit 384 par. 1 pika 1. 12 lidhur me neni 370 të KPPK, sepse në aktgjykimet janë të pa qartë dhe të pa kuptueshëm, në të nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare në veçanti në atë të shkallës së parë. Më tej, theksohet se aktgjykimi i shkallës së dytë është i pa qartë dhe i pakuptueshëm për faktin se nga ai nuk mund të kuptohet nëse ankesa e mbrojtësit është hedhur apo refuzuar. në arsyetimin e aktgjykimit mungojnë arsye për faktet vendimtare lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk ka arsyetim përse ankesa e mbrojtësit të të dënuarit, është refuzuar shkelje këto që të cilat aktgjykimin bënë të paqëndrueshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara pretendimet e lartë cekura. Në kërkesë, përveç që citohet dispozita ligjore, nuk ka arsyetim se ku konkretisht qëndrojnë shkeljet e pretenduara. Megjithatë, kjo gjykatë konsideron se aktgjykimet e kundërshtuara, pra edhe dispozitivi janë të qartë dhe konkret, në të janë dhënë arsye të qarta lidhur me faktet vendimtare, vlerësimi i provave të administruar është bërë në pajtim të plotë me dispozitën e nenit 370 par. 7 të KPPK, për çfarë në të dy aktgjykime janë dhënë arsye të plota. Në aktgjykimin e shkallës së dytë, në dispozitiv në mënyrë decisive është konstatuar:”ankesat e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe mbrojtësit të të akuzuarës S. B. dhe të mbrojtësit të akuzuarit F. S., refuzohen si të pabazuara”, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të plota për të gjitha faktet relevante si kurse edhe për të gjitha pretendimet të paraqitura në ankesë, prandaj pretendimet kërkesa qartazi dalin si të pabazuara.

Pjesa tjetër e kërkesës, ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal ashtu që në kërkesë potencohet se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ka kryer veprën penale, theksohet se të dy gjykatat e vendimet e tyre, bazojnë vetëm në supozime kështu që

në rastin konkret do të duhej të aplikohet instituti “*in dublo pro reo*”. Kjo gjykatë vlerëson se pretendimet në fjalë i përkasin gjendjes së fakteve për çfarë nuk mund të paraqitet ky mjet juridikë.

Megjithatë, kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e lartcekura nuk e vënë në dyshim gjendjen e fakteve të vërtetuara dhe aplikimin e ligjit penal.

Në këtë çështje, me asnjë provë të administruar nuk vihet në dyshim përgjegjësia penale të të dënuarit F. S., përkitazi me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar.

Në këtë çështje penale nuk kanë qenë kontestuese këto fakte: se i dënuari F. S., është dhëndri – burri i motrës së të dënuarës S., ndërsa G. B., bashkëshorti i S. E dënuara S. dhe bashkëshorti i sajë G. B. i cili aktualisht ndodhet në arrati, janë pronar të disa dyqaneve të mobiljeve në Pejë. Nuk është kontestues fakti se të gjithë së bashku, disa herë kanë shkuar në Turqi, për të blerë mall për dyqan, gjëra të ndryshme si çarqaf, perde, mbulesa etj. Nuk është kontestuese se i dënuar F. për çdo shkuarje në Turqi, është kompensuar nga bashkëshorti i S. si dhe fakti se edhe ditën kritike së bashku kanë qenë në Turqi. Mallin i blerë në Turqi, është paketuar-vendosur në valixhe në ambientet e hotelit ku ata ishin të vendosur. Me këtë rast është paketuar “mall” në tetë valixhe të cilat në Stamboll janë dorëzuar në agjension “.....”, për tu transportuar në Kosovë, ndërsa këta të dy të dënuarit nga Stambolli janë kthyer me aeroplan në Prishtinë. Nuk kanë qenë kontestues fakti se nga doganierët në valixhet e cekura është zbuluar substanca narkotike të llojit heroin në peshë prej 22.992,40 gram. Kontestuese ka qenë a e ka ditur i dënuari F., për përmbajtjen e paketimeve dhe a ka ndihmuar i njëjti në vendosjen e tyre në valixhet.

Se pikërisht i dënuari F., ka marrë pjesë në paketimin e substancës narkotike në valixhet e përmendura ndonëse ai kategorikisht ka mohuar një gjë të tillë në mbrojtjen e tij, në menyrë të pa dyshimit është vërtetuar në radhë të parë nga raporti i Forenzikës të Njesitit për Ekspertim Traesologjik dhe Daktiloskopik i AKF të datës 09.02.2012 nga i cili raport rezulton se është vërtetuar prania e gjurmëve-vijave

papilare të gjetura në paketimet ku ka qenë e vendosur substanca narkotike. Gjurmët e gjetura i përkasin të pandehurit G. B. dhe të dënuarit F. S..

Në mbështetje të provave të administruara nuk është vënë në dilemë ndërmarrja e veprimeve inkriminuese nga i dënuari F.

Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me gjendjen e fakteve dhe aplikimin e ligjit penal, të cilin e ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë, për çfarë në arsyetimin e vendimeve të tyre, janë dhenë arsye të plota, si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga arsye të paraqitura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

PML.nr.77/2016 më 17 maj 2016

Procesmbajtësja,  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit  
Avdi Dinaj